

1.3.1	Sertraline
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

PËRMBLEDHJE E KARAKTERISTIKAVE TË PRODUKTIT

1. EMRI I PRODUKTIT MEDICINAL

Asentra® 50 mg film tableta të mbështjellura
Asentra® 100 mg film tableta të mbështjellura

2. PËRBËRJA KUALITATIVE DHE KUANTITATIVE

1 film tabletë e mbështjellur përmban 50 mg sertralin në formë të 55,95 mg hidroklorurit të sertralinës ose 100 mg sertralin në formë të 111,90 mg hidroklorurit të sertralinës.

Për listën e plotë të substancave shtesë, shih seksionin 6.1.

3. FORMA FARMACEUTIKE

Film tablet të mbështjellura

50 mg: Tabletat janë të bardha, të rrumbullakëta (diametri është 8 mm), të ndara në një anë. Tableta mund të ndahet në dy doza të barabarta.

100 mg: Tabletat janë të bardha, të rrumbullakëta (diametri është 11 mm), të ndara në një anë. Tableta mund të ndahet në dy doza të barabarta.

4. KARAKTERISTIKAT KLINIKE

4.1 Indikacionet terapeutike

Asentra ju dedikohet të rriturve për:

- trajtimin e dozave të larta të depresionit,
- parandalimin e përsëritur të dozave të larta të depresionit,
- trajtimin e çrregullimeve të panikut, me ose pa agorafobi,
- trajtimin e çrregullimeve opseshivo-kompulsive (OCD),
- trajtimin e ankthit social,
- trajtimin post traumatik të çrregullimeve të stresit (PTSP).

Asentra ju dedikohet fëmijëve dhe adoleshentëve të moshës 6 deri 17 vjet për:

- trajtimin e çrregullimeve obseshivo-kompulsive.

4.2 Dozimi dhe mënyra e përdorimit

Dozimi

Terapia fillestare

Depresioni dhe OKP

Terapia me sertralin duhet të fillojë me dozën ditore prej 50 mg.

Çrregullimi i panikut, PTSP dhe çrregullimi i ankthit social

1.3.1	Sertraline
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

Terapia duhet të fillojë me 25 mg/në ditë. Pas një jave, dozën duhet rritur në 50 mg/ një here në ditë. Është treguar se ky regjim dozimi zvogëlon paraqitjen e shpeshtë të efekteve të padëshiruara në fillim të terapisë, karakteristike për çrregullimin e panikut.

Rregullimi i dozës

Depresioni, OKP, çrregullimi i panikut, çrregullimi i ankthit social dhe PTSP

Pacientëve të cilëve nuk iu përgjigjet doza prej 50 mg mund të jetë e dobishme rritja e dozës. Ndryshimet e dozës duhet të bëhen në hapa prej 50 mg dhe intervale së paku prej një jave, deri në maksimum 200 mg/në ditë. Ndryshimet e dozës nuk duhet të bëhen më shpesh se një herë në javë, duke marrë parasysh atë se koha e gjysëm eliminimit të sertralinës është 24 orë.

Fillimi i veprimit terapeutik mund të shihet brenda 7 ditëve. Megjithatë, periudhat më të gjata janë zakonisht të domosdoshme për ta treguar përgjigjen terapeutike, posaçërisht tek OKP.

Mbajtja e terapisë

Dozimi gjatë terapisë afatgjate duhet të mbahet në nivelin efikas më të vogël, me përshtatjen e mëvonshme të dozës varësisht nga përgjigja terapeutike.

Depresioni

Terapia afatgjate mund të aplikohet për parandalimin e përsëritjes së epizodeve të mëdha depressive (MDE). Në shumicën e rasteve, doza e preferuar në parandalimin e përsëritjes të MDE është e njëjtë si ajo e cila përdoret gjatë epizodeve ekzistuese. Pacientët e sëmurë nga depresioni duhet të trajtohen mjaft gjatë, së paku 6 muaj, për tu siguruar që simptomat nuk do të përsëriten.

Çrregullimi i panikut dhe OKP

Terapinë e vazhdueshme të çrregullimit të panikut dhe OKP duhet rregullisht vlerësuar, sepse nuk është dëshmuar parandalimi i rikthimit të këto çrregullime.

Popullata pediatrike

Fëmijët dhe adoleshentët me çrregullim opseshivo-kompulziv

Mosha 13-17 vjet: Doza fillestare është 50 mg një herë në ditë.

Mosha 6-12 vjet: Doza fillestare është 25 mg një herë në ditë. Doza mund të rritet në 50 mg një herë në ditë, pas një jave.

Më vonë dozat mund të rriten në rast të përgjigjes së pakënaqshme me nga 50 mg, gjatë periudhës prej disa javë, sipas nevojës. Doza maksimale është 200 mg në ditë. Megjithatë, duhet marrë parasysh zakonisht peshën më të ulët trupore të fëmijëve në krahasim me të rriturit, kur doza rritet me 50 mg. Doza nuk guxon të rrdyshohet në intervale më të vogla se një javë.

Efikasiteti nuk është dëshmuar tek pacientët pediatrik me çrregullime të mëdha depressive.

Nuk ka të dhëna në dispozicion për fëmijët më të vogël se 6 vjet (shih seksionin 4.4).

Pacientët e moshuar

Të moshuarve bari duhet ti dozohet me kujdes sepse tek ata ekziston rreziku më i lartë nga hiponatremia (shih seksionin 4.4)

Pacientët me dëmtim të mëlçisë

Sertralina tek pacientët me sëmundje të mëlçisë duhet ta aplikohet me kujdes. Tek pacientët me mëlçinë e dëmtuar duhet aplikuar doza më të vogla (shih pikën 4.4). Sertralina nuk duhet të aplikohet

1.3.1	Sertraline
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

në rastet e dëmtimit serioz të funksionit të mëlçisë, ngase nuk kemi të dhëna klinike (shih seksionin 4.4).

Pacientët me dëmtim të veshkave

Tek pacientët me insuficiencë të veshkave nuk nevojitet përshtatja e dozës (shih seksionin 4.4).

Mënyra e aplikimit

Sertralin duhet marrë një here në ditë, në mëngjes ose në mbrëmje.

Sertralin tabletat mund të merren me ushqim ose në stomak bosh.

Sindromi i ndërprerjes së sertralinës

Duhet shmangur ndërprerjen e menjëhershme të terapisë. Gjatë pezullimit dozën duhet zvogëluar gradualisht gjatë periudhës prej së paku dy javë për ta zvogëluar rrezikun nga reaksioni apstinencial (shih pikën 4.4 dhe 4.8). Nëse paraqiten simptome të cilat janë të vështira pas zvogëlimit të dozës dhe pas ndërprerjes së terapisë, mund të shqyrtohet vazhdimi me dozën e caktuar më parë. Më vonë, mjeku mund ta vazhdojë zvogëlimin e dozës, por me kujdes dhe gradualisht.

4.3 Kontraindikacionet

Ndjeshmëria në substancën aktive ose në cilën do substancë aktive të numëruar në seksionin 6.1.

Aplikimi shoqërues me inhibitorë ireverzibil të monoaminooksidazës (MAOI) është i kundërlinduar për shkak të rrezikut nga sindromi serotonin me simptome siç janë shqetësimi, dridhje dhe hipertermi. Sertralina nuk guxon të futet së paku 14 ditë pas pezullimit të terapisë me barna ireverzibile MAOI. Sertralina duhet të pezullohet së paku 7 ditë para se të fillojë terapia me barna ireverzibile MAOI (shih pikën 4.5).

Aplikimi i njëkohshëm me pimozidom është kundërlinduar (shih seksionin 4.5).

4.4 Vërejtje të posaçme dhe masat e kujdesit gjatë aplikimit të barit

Sindromi serotonin (SS) ose Sindromi malinjë neuroleptik(NMS)

Zhvillimi i sindromit, potencial të rrezikshëm për jetën, siç është sindromi serotonin (SS) ose sindromi malinjë neuroleptik (NMS) ka qenë i lajmëruar me barnat e grupit SSRI, përfshirë edhe trajtimin me sertralinën. Rreziku nga SS ose NMS me barnat e grupit SSRI është rritur njëkohësisht me aplikimin e barnave serotonergjik, (përfshirë edhe antidepressantët tjerë serotonergjik, amfetaminet, triptanët), me barna të cilët ndikojnë në metabolizmin e serotoninës, (përfshirë barnat e grupit MAOI, p.sh. metilenin blu), antipsihotikët dhe antagonistët dopaminik. Pacientët duhet monitoruar për shkak të paraqitjes eventuale të shenjave dhe simptomave SS ose sindromit NMS, (shih pikën 4.3).

Kalimi prej inhibitorëve selektiv të rimarrjes së serotoninës (SSRI), barnave antidepressive ose antiopsesive

Përvoja e kontrolluar lidhur me kohën optimale e kalimit prej barnave të grupit SSRI, antidepressivëve ose antiopsesivëve në sertralin është e kufizuar. Duhet me kujdes dhe vlerësim të arsyeshëm medicinal të vendoset kur duhet të bëhet kalimi, posaçërisht me barnat të cilët kanë efekt afatgjatë, siç është fluoksetina.

Barnat e tjera serotonergjike, p.sh. triptofan, fenfluramin dhe antagonist 5-HT

Aplikimi shoqërues i sertralinës me barna tjerë të cilët përforcojnë efektin e neurotransmisionit serotonergjik siç janë amfetaminet, triptofan ose fenfluramin apo antagonistët 5-HT ose barin bimor kantarion (*Hypericum perforatum*), duhet me kujdes të aplikohet dhe atëherë kur është e mundur, të shmangët për shkak të mundësisë të interakcionit farmakodinamik.

1.3.1	Sertraline
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

QTc prolongimi/Torsade de Pointes (TdP)

Rastet e zgjatjes së QT intervaleve dhe *Torsade de Pointes* (TdP) janë vënë re gjatë aplikimit të sertralinës në periudhën e postmarketingut. Ndikimi në kohëzgjatjen e QT intervaleve është vërtetuar në studim QT të detajuar tek vullnetarët e shëndoshë, me marrëdhënie statistikisht të rëndësishme positive të eksponimit dhe reagimit. Prandaj, sertralina duhet të përdoret me kujdes tek pacientët me faktorë të shtuar të rrezikut për zgjatjen e QT, siç janë sëmundjet e zemrës, hipokaliemia, ose hipomagnezemia, anamneza familjare e zgjatjes së QT, bradikarditë dhe aplikimi i njëkohshëm i barnave të cilat zgjatin intervalin e QT-së (shihni seksionet 4.5 dhe 5.1).

Aktivimi i hipomanisë ose manisë

Është regjistruar se tek një numër i vogël i pacientëve trajtimi me barna antidepressive ose antiopsesive të cilët ekzistojnë në treg, përfshirë edhe sertralinën, janë paraqitur simptome të manisë/hipomanisë. Prandaj sertralinën duhet përdorur me kujdes tek pacientët me mani/hipomani në anamnezë. Nevojitet monitorimi me kujdes nga ana e mjekut. Sertralinën duhet ndërprerë tek pacientët të cilët hynë në fazën e manisë.

Shizofrenia

Simptomat psikotike tek pacientët me shizofreni mund të përkeqësohen.

Konvulsionet

Konvulsionet mund të paraqiten me terapinë me sertralinën: duhet shmangur tek pacientët me epilepsi jostabile, ndërsa pacientët me epilepsi të kontrolluar duhet të monitorohen me kujdes. Sertralinën duhet pezulluar tek pacientët të cilët paraqiten konvulsione.

Suicidi/mendimet suicidale/tentim i vetvrasjes ose përkeqësimi klinik

Depresioni lidhet me rrezikun e shtuar nga mendimet suicidale, vetlëndimet dhe vetvrasjet (ngjarjet lidhur me vetvrasjen). Ky rrezik ekziston deri te arritja e theksuar e ndjesës. Pasi që përmirësimi nuk do të vjen në javët e para të terapisë ose më shumë, pacientët duhet monitoruar me kujdes derisa nuk vjen te përmirësimi. Ekziston përvojë e përgjithshme klinike se rreziku nga vetvrasja rritet në fazën e hershme të përmirësimit.

Gjendjet tjera psikiatrike, për të cilat përshkruhet sertralina, gjithashtu mund të lidhen me rrezikun e shtuar prej ngjarjeve të lidhura me vetvrasjen. Përveç kësaj, këto gjendje mund të jenë komorbide me çrregullime të mëdha depresive. Të njëjtat masa të kujdesit të cilat aplikohen kur të trajtohen pacientët me depresion të madhë duhet, për shkak të kësaj, aplikuar edhe kur trajtohen pacientët me çrregullime tjera psikiatrike.

Është e njohur se te pacientët të lidhur me ngjarjet me vetvrasje në anamnezë dhe te ata të cilët kanë shprehur shqallë të konsiderueshme të fiksimit suicidal para fillimit të terapisë, ekziston rrezik më i madh nga mendimet suicidale ose tentim i vetvrasjes, prandaj me kujdes duhet të monitorohen gjatë terapisë. Meta analizat e hulumtimeve klinike të kontrolluara me placebo antidepressive, tek pacientët e rritur me çrregullime psikiatrike, kanë treguar rrezik të shtuar nga sjelljet suicidale me antidepressiv, në krahasim me placebo, tek pacientët më të ri se 25 vjet.

Terapia me bar duhet të bëhet me mbikqyrje të kujdeshme të pacientëve, para se gjithash të atyre me rrezik të shtuar, posaçërisht në fillim të terapisë dhe pas ndryshimit të dozës. Pacientët (dhe ata të cilët përkujdesen për pacientët) duhet paralajmëruar për nevojën e monitorimit të cilit do përkeqësim klinik, sjelljes suicidal ose mendimeve dhe ndryshimeve të pazakonta në sjellje dhe të udhëzohen që të kërkojnë këshillat urgjente medicinale nëse këto simptome janë prezente.

Popullata pediatrike

1.3.1	Sertraline
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

Sertralina nuk guxon të përdoret për trajtimin e fëmijëve dhe adoleshentëve më të ri se 18 vjet, përveç te pacientët me çrregullime opsive-kompulzive, të moshës 6-17 vjet. Sjellja e lidhur me suicidin (tentim i vetvrasjes ose duke menduar për vetvrasjen) dhe qëndrimet armiqësore (më së shpeshti agresioni, konfrontimi me të tjerët dhe bujë) shpesh janë aplikuar në hulumtimet klinike ndër fëmijë dhe adoleshentë të trajtuar me antidepressiv në krahasim me ata të cilët janë trajtuar me placebo. Nëse në bazë të këtij vlerësimi klinik mjeku megjithatë vendosë për trajtim me këtë bar, pacientët duhet të monitorohen me kujdes për shkak të paraqitjes të simptomave suicidal. Përveç kësaj, nuk ka të dhëna për padëmshmërinë gjatë përdorimit afatgjatë të barit tek fëmijët dhe adoleshentët kur është në pyetje rritja, pjekuria dhe zhvillimi kognitiv dhe bihevioural. Janë lajmëruar disa raste të çrregullimit të rritjes dhe pubertetit të vonuar post-marketing. Rëndësia klinike dhe shkak janë akoma të paqarta (shih seksionin 5.3 për të dhënat e sigurisë të paraklinikave përkatëse). Mjekët duhet të monitorojnë paraqitjen e mundshme të çrregullimeve në sistemet e organeve te pacientët pediatrik në terapi afatgjate.

Gjakderdhja e pazakontë/hemoragjia

Ka pasur të raportuara probleme me gjakderdhje të pazakontë me SSRI, duke përfshirë gjakderdhjen nga lëkura, siç janë ekhimozat dhe purpurat dhe rastet tjera të hemoragjisë, të tilla si gjakderdhja gastrointestinale ose gjinekologjike, duke përfshirë hemoragjitë fatale.

Këshillohet kujdes te pacientët të cilët përdorin barnat e grupit SSRI, posaçërisht nëse në të njëjtën kohë aplikohen edhe barna tjera për të cilët dihet se ndikojnë në funksionin e pllakave të gjakut (p.sh. antikoagulansët, antipsikotikët atipik dhe fenotiazina, shumica e antidepressivëve triciklik, acidi acetilsalicik dhe barna josteroid antiinflamator – NSAIL) si dhe tek pacientët me çrregullime të gjakderdhjes në anamnezë (shih seksionin 4.5).

Hiponatremia

Mund të paraqitet si pasojë e terapisë me bar të grupit SSRI ose SNRI, përfshirë edhe sertralinën. Në shumë raste, duket se hiponatremia paraqitet si rezultat i tajitjes joadekuate të hormoneve antidiuretike (SIADH). Janë regjistruar raset e koncentrimin të natriumit në serume më të vogla se 110 mmol/l. Pacientët e moshuar mund të kenë rrezik të shtuar nga paraqitja e hiponatremisë me barnat e grupit SSRI dhe SNRI. Gjithashtu, pacientët të cilët përdorin diuretikë ose ata të cilët në ndonjë mënyrë tjetër janë hipovolemik, mund të kenë rrezik të shtuar (shih „Përdorimi tek personat e moshuar“). Duhet shqyrtuar pezullimin e sertralinës tek pacientët me hiponatremi simptomatike dhe aplikuar intervenimin përkatës medicinal. Shenjat dhe simptomet e hiponatremisë përfshijnë kokëdhembjen, problemet me koncentrimin, çrregullimi i të mbajturit në mend, konfuzion, dobësimi dhe jostabiliteti, çka mund të sjellë deri tek shembja. Shenjat dhe simptomet janë të lidhura me rastet serioze dhe/ose akute ku janë përfshirë halucinacionet, sinkopë, konvulsionet, koma, ngecjet respiratore dhe vdekja.

Simptomat të cilat paraqiten gjatë ndërprerjes të trajtimit me sertralin

Simptomat e apstinencës me rastin e ndërprerjes të terapisë janë të shpeshtë, posaçërisht nëse ajo ndërprehet papritmas (shih pikën 4.8). Në hulumtimet klinike ndër pacientët të cilët kanë përdorë sertralin, incidenca e regjistruar e reaksioneve të apstinencës ka qenë 23% tek ata të cilët e kanë ndërprerë marrjen e sertralinës, në krahasim me 12% tek ata të cilët kanë vazhduar terapinë me sertralin.

Rreziku nga paraqitja e simptomave të pezullimit varet nga kohëzgjatja e terapisë, dozat e aplikuara dhe ritmi i zvogëlimit të dozës. Marramendja, çrregullimi i ndjesave (përfshirë parestezinë), çrregullimi i gjumit (përfshirë pagjumsinë dhe ëndrrat intenzive), shqetësimi dhe tensionet, të përziera dhe/ose të vjella, dridhja dhe kokëdhimbja janë reaksionet që janë regjistruar më së shpeshti. Përgjithësisht, këto simptome janë të buta dhe të matura, megjithatë, te disa pacientë mund të jenë të intenzitetit serioz. Këto zakonisht lajmërohen gjatë disa ditëve pas ndërprerjes të terapisë, por shumë rrallë janë shënuar këto simptome edhe tek pacientët të cilët pa qëllim e kanë harruar dozën. Zakonisht këto simptome janë të kufizuar dhe më së shpeshti zhduken në afatin prej 2 javë, edhe pse tek disa individë mund të vazhdojnë (2-3 muaj ose më gjatë). Prandaj këshillohet që sertralina të zvogëlohet

1.3.1	Sertraline
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

gradualisht gjatë ndërprerjes të terapisë, gjatë periudhës prej disa javë ose muaj, në përputhje me nevojat e pacientëve (shih pikën 4.2).

Akatizia/shqetësimi psikomotorik

Përdorimi i sertralinës ka qenë i lidhur me zhvillimin e akatizisë, i cili manifestohet me ndjenjat subjektive të pakëndshme ose shqetësime të dhimbshme dhe nevojën për lëvizje, që shpesh është përcjellë me pamundësinë e qëndrimit të qetë ulur ose qëndrimin në këmbë. Mundësia më e madhe që kjo të paraqitet është gjatë disa javë të para të terapisë. Te pacientët tek të cilët paraqiten këto simptome, rritja e dozës mund të jetë e dëmshme.

Dëmtimi i mëlçisë

Sertralina në masë të kosiderueshme metabolizohet në mëlçi. Në hulumtimet farmakokinetike me dozimin e disahershëm tek pacientët me cerozë të butë dhe të qëndrueshme të mëlçisë, është vërtetuar zgjatja e gjysmuar e sekretimit dhe gati trefishimi i rritjes të sipërfaqës nën lakoren e përqëndrimit (PIK), respektivisht përqëndrimi maksimal në plazmë (C_{max}) në krahasim me grupin kontrollues. Nuk janë vërejtur dallime të rëndësishme në lidhjen me proteinat e plazmës ndërmjet dy grupeve të lartë përmendura. Kujdesi është i domosdoshëm gjatë aplikimit të sertralinës te pacientët me insuficiencën e mëlçisë. Te pacientët me funksion të zvogëluar të mëlçisë duhet dhënë doza më të vogla të sertralinës ose të vazhdohet intervali kohor ndërmjet dozimit. Nuk preferohet aplikimi i sertralinës tek pacientët me insuficiencë të rëndë të mëlçisë (shih seksionin 4.2).

Dëmtimi i veshkës

Sertralina metabolizohet ekstenzivisht dhe ekskrecioni i barit të pandryshuar në urinë është rruga e dorës së dytë të eliminimit. Në studimin me pacientët me dëmtim të butë ose të matur të funksionit të veshkës (klirensi i kreatinës 30-60 ml/min) ose dëmtimi i matur deri tek ai i rëndë i veshkës (klirensi i kreatinës 10-29 ml/min), parametrat farmakokinetik i dozave të shumta (PIK 0-24 ili C_{max}) nuk kanë qenë dukshëm të ndryshme në krahasim me atë kontrollues. Dozimi me sertralin nuk ka nevojë të përshtatet në bazë të shkallës së dëmtimit të funksionit të veshkës.

Pacientët e moshuar

Mbi 700 pacientë të moshuar (>65 vjet) kanë marrë pjesë në hulumtimet klinike. Formulari dhe incidence e reaksioneve të padëshiruara tek pacientët e moshuar kanë qenë të ngjajshëm si edhe tek të rinjtë.

Aplikimi i barnave nga grupi i SSRI-së dhe SNRI-së, duke përfshirë edhe sertralinën, ka qenë e lidhur me rastet e hiponatremisë të rëndësishme klinikisht te personat e moshuar, që mund të jenë në rrezik të shtuar nga shkaktimi i këtij veprimi të padëshirueshëm (shih Hiponatremia në seksionin 4.4).

Diabeti

Te pacientët me diabet, terapia me barna nga grupi SSRI mund të shkaktojë ndryshime në kontrollin e glikemisë. Mund të nevojitet përshtatshmëria e dozës së insulinës dhe/ose barnave orale hipoglikemike.

Terapia elektrokonvulsive

Nuk ka hulumtime klinike të cilët do për ta përcaktuar rrezikun ose përfitimin e përdorimit të kombinuar të sertralinës dhe EKT.

Lëng grejpfruti

Nuk preferohet aplikimi i sertralinës me lëng grejpfruti (shih seksionin 4.5).

Përzierja e ekzaminuar në testet e urinës

Testet imunologjike të rreme-pozitive të ekzaminuar në testet e urinës për benzodiazepin janë lajmëruar tek pacientët të cilët marrin sertralin. Kjo është për shkak të mungesës së specifikacitetit të

1.3.1	Sertraline
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

testeve të ekzaminuara. Testi i rremë pozitiv mund të pritët disa ditë pasë ndërprerjes të terapisë me sertralin. Testet e konfirmimit siç janë hromatografia gazit/spektrometria masive do ta ndajë sertralinën nga benzodiazepina.

Këndi i mbylljes glaukomë

SSRI, përfshirë sertralinën, mund të ketë efekt në madhësinë e bebjës çka rezulton në midriazë. Ky efekt midriaz ka potencial ta ngushtojë këndin e syrit, që sjell te rritja e presionit intraokular dhe këndi i mbylljes glaukomë, posaçërisht tek pacientët me predispozicione. Prandaj, sertralinën duhet aplikuar me kujdes tek pacientët me këndin e mbylljes glaukomë ose historinë glaukomë.

Disfunksioni seksual

Inhibitorët selektiv të përdorimit të sërishëm të serotoninës (SSRI)/inhibitorët e përdorimit të sërishëm të serotonin-norepinefrinës (SNRI) mund të shkaktojnë simptoma të disfunksionit seksual (shihni seksionin 4.8). Ka pasur raportime për disfunksionin afatgjatë seksual ku simptomat kanë vazhduar përkundër ndërprerjes së marrjes së SSRI/SNR-së.

Natriumi

Ky bar përmban më pak se 1 mmol natrium (23 mg) për tabletë, që mund të thuhet se në esencë është “pa natrium”.

4.5 Interakcioni me barnat e tjera dhe llojet tjera të interakcionit

Aplikimi i kundërlindikuar

Inhibitorët e monoaminooksidazës

Barnat ireverzibel (joselektive) të grupit MAOI (p.sh. selegilina)

Sertralina nuk guxon të përdoret në kombinim me barnat ireverzibile (joselektive) të grupit MAOI, siç është selegilina. Sertralina nuk guxon të futet së paku 14 ditë pas pezullimit të terapisë me barnat ireverzibile (joselektive) MAOI. Sertralina duhet të pezullohet së paku 7 ditë para fillimit të terapisë me barnat ireverzibile (joselektive) MAOI (shih seksionin 4.3).

Inhibitorët reverzibil, selektiv MAO-A (moklobemid)

Për shkak të rrezikut nga sindromi serotoninik, kombinimi i sertralinës me barnat reverzibile selektive MAOI, siç është moklobemid nuk preferohet. Pas terapisë me inhibitorët reverzibil MAO, mund të aplikohet periudha e shkurtë e tërheqjes së barit prej 14 ditë para se të fillojë terapia me sertralin. Rekomandohet që sertralina patjetër të pezullohet së paku 7 ditë para fillimit të terapisë me barnat reverzibile MAOI (shih seksionin 4.3).

MAO reverzibil, joselektiv (linezolid)

Antibiotiku linezolid është MAO inhibitorë i dobët reverzibil dhe joselektiv dhe nuk duhet dhënë pacientëve të cilët trajtohen me sertralin (shih pikën 4.3).

Efektet serioze të padëshiruara janë regjistruar te pacientët tek të cilët kohëve të fundit është pezulluar terapia me barnat e grupit MAOI dhe ka filluar terapia me sertralin, ose te ata tek të cilët kohëve të fundit është ndërprerë terapia me sertralin para se të futet terapia me inhibitorët MAO. Këto reaksione kanë përfshirë tremorin, mioklonusin, diaforezën, të përziera, të vjella, të skuqurit, marramendje dhe hipertermi me karakteristikat të cilat ngjajnë në sindromin malinj neuroleptik, konvulsione dhe vdekja.

Pimozid

Në studimin me dozën e vogël individuale të pimozid (2 mg), është vërejtur rritja e përqendrimit të pimozid përafërsisht për 35%. Këto nivele të rritura nuk kanë qenë të lidhura me çfarëdo ndryshimi në EKG. Edhe pse mekanizmi i këtij interreaksioni është i panjohur, përdorimi i njëkohshëm i sertralinës dhe pimozidit është i kontrainsikuar për shkak të indeksit terapeutik të pimozidit (shih seksionin 4.3).

1.3.1	Sertraline
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

Aplikimi shoqërues me sertralinën nuk preferohet

Depresori CNS dhe alkoholi

Aplikimi shoqërues i sertralinës prej 200 mg në ditë nuk e ka përforcuar efektin e alkoholit, karbamazepinës, haloperidolit ose fenitoinës në aftësitë kognitive dhe psikomotorike tek të anketuarit e shëndetshëm. Megjithatë, aplikimi shoqërues i sertralinës dhe alkoholit nuk preferohet.

Barnat e tjera serotonergike

Shih pikën 4.4.

Kujdesi këshillohet, gjithashtu me fentanilën (të aplikuar në anestezionin e përgjithshëm ose në trajtimin e dhimbjes kronike), barnat e tjera serotonergike (përfshirë antidepressivët tjerë serotonergik, amfetaminet, triptanët), dhe opiateve tjera.

Masat e posaçme të kujdesit

Barnat të cilët vazhdojnë intervalin QT

Rreziku nga vazhdimi i QTc dhe/ose aritmia ventrikulare (p.sh. TDP) mund të rritet me aplikimin shoqërues të barnave tjera të cilët vazhdojnë intervalin QTc (p.sh. disa antipsikotik dhe antibiotik) (shih seksionin 4.4 dhe 5.1).

Litiumi

Në hulumtimet e kontrolluara- placebo në vullnetarët e shëndoshë, aplikimi shoqërues i sertralinës me litiumin nuk e ka ndryshuar dukshëm farmakokinetikën e litiumit, por ka sjell deri te rritja e tremorit në krahasim me placebon, që tregon në interakcionin e mundshëm farmakodimik. Kur sertralina aplikohet njëkohësisht me barna siç është litiumi, pacientin duhet monitoruar në mënyrë adekuate.

Fenitoina

Studimi i kontrolluar i placebos në vullnetarët e shëndoshë tregon në atë se aplikimi kronik i sertralinës prej 200 mg/në ditë nuk krijon frenim të rëndësishëm klinik të metabolizmit të fenitoinës. Megjithatë, pasi që në disa raste është paraqitë ekspozimi i lartë i fenitoinës tek pacientët të cilët kanë përdorë sertralinën, preferohet monitorimi i përqëndrimit të fenitoinës në plazmë, pas futjes së terapisë me sertralin, me përshtatjen adekuate të dozës së fenitoinës. Përveç kësaj, aplikimi shoqërues i fenitoinës mund të shkaktojë zvogëlimin e nivelit të sertralinës në plazmë. Nuk mund të përjashtohen që induktorët tjerë CIP3A4, p.sh. fenobarbitali, karbamazepina, kantarioni, rifampicini, mund të shkaktojnë zvogëlimin e nivelit të sertralinës në plazmë.

Triptani

Ka pasur lajmërimi postmarketingu pas paraqitjes të barit në treg ku është përshkruar dobësia, hiper refleksioni, koordinimi i dobët i lëvizjes, konfuzioni, shqetësimi dhe tensione te pacientët pas përdorimit të sertralinës dhe sumatriptanit. Simptomet e sindromit serotonergik mund të lajmërohen edhe me barnat e tjera të njëjtit lloj (triptani). Nëse trajtimi shoqërues i sertralinës dhe triptanit është klinikisht i domosdoshëm, këshillohet monitorimi adekuat i pacientit (shih seksionin 4.4).

Varfarina

Aplikimi shoqërues i sertralinës prej 200 mg në ditë me varfarinën ka sjell deri te rritja e vogël por klinikisht e rëndësishme e kohës protrombique, e cila në disa raste të rralla ka sjell deri te çrregullimi i marrëdhënieve INR. Në përputhje me këtë, duhet me kujdes të monitorohet koha protrombique kur të futet ose ndërprehet terapia me sertralin.

Interakcionet tjera të barit, digoksin, atenolol, cimetidin

Nuk janë vërejtur interaksione të sertralinës prej 200 mg në ditë me digoksin.

1.3.1	Sertraline
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

Sertralina nuk ka pasur efekt në aftësinë e bllokimit beta-adrenergik të atenololit. Aplikimi shoqëruar me cimetidin ka shkaktuar zvogëlimin e konsiderueshëm të klirensit të sertralinës. Rëndësia klinike e këtyre gjetjeve nuk është e njohur.

Barnat të cilat ndikojnë në funksionin e trombocitëve

Rreziku nga gjakderdhja mund të përforcohet kur barnat të cilat ndikojnë në funksionin e trombocitëve (p.sh. barnat e grupit NSAID, acidi acetilsalicilin dhe tiklopidini) ose barnat e tjera të cilët mund ta shtojnë rrezikun nga gjakderdhja kur aplikohen njëkohësisht me barnat e grupit SSRI, përfshirë edhe sertralinën (shih seksionin 4.4).

Bllikatorët neuromuskular

SSRI mund të zvogëlojnë aktivitetin e kolinesterazës në plazmë që rezulton në një zgjatje të veprimit bllokues neuromuskular të mivakuriumit ose bllokuesve të tjerë neuromuskular.

Barnat të cilat metabolizohen me citokrom P450

Sertralina mund të veprojë si inhibitor i butë dhe i matur CYP 2D6. Dozimi kronik i sertralinës prej 50 mg në ditë ka treguar rritje mesatare (prosečno 23%–37%) të gjendjes stabile të koncentrimin të dezipraminës në plazmë (shënuesi i aktiviteteve të izoenzimeve CYP 2D6). Rëndësia klinike dhe interakcionet e rëndësishme mund të lajmërohen me substratet tjera CYP 2D6 me indeks terapeutik të ngushtë siç janë antiaritmikët e klasës IC, si propafenoni dhe flekainidi, TCA antidepressiv dhe antipsikotikët tipik, posaçërisht me doza më të mëdha të sertralinës.

Sertralina nuk vepron si inhibitor CYP 3A4, CYP 2C9, CYP 2C19 dhe CYP 1A2 në masë të konsiderueshme klinike. Kjo është konfirmuar në studimet e interakcionit *in vivo* me substratet CYP3A4 (kortizol endogjeni, karbamazepini, terfenadini, alprazolami), substrati CYP2C19, diazepam dhe substratet CYP2C9 – tolbutamid, glibenklamid dhe fenitoin. Studimet *in vitro* kanë treguar që sertralina ka pak, ose kurrfarë potenciali si inhibitor CYP 1A2.

Duke marrë tri gota lëng grejpfruti në ditë është rritur niveli i sertralinës në plazmë për rreth 100% në studimin e tetë subjekteve të shëndosha Japoneze. Prandaj duhet shmangur lëngun e grejpfrutit gjatë aplikimit të sertralinës. (Shih seksionin 4.4).

Në bazë të studimit të interakcionit me lëngun e grejpfrutit, nuk mund të përjashtohet aplikimi shoqëruar i sertralinës dhe inhibitorëve të fuqishëm CYP3A4, p.sh. ketokonazoli, itrakonazoli, pozakonazoli, vorikonazoli, klaritromicini, telitromicini dhe nefazodoni, do të sjell deri te çrregullimet edhe më të mëdha të ekspozimit të sertralinës. Kjo gjithashtu ka të bëjë edhe me inhibitorët mesatar CYP3A4, p.sh. aprepitant, eritromicin, fluconazol, verapamil dhe diltiazem. Aplikimin e inhibitorëve të fuqishëm CYP3A4 duhet shmangur gjatë terapisë me sertralin.

Nivelet e sertralinës në plazma janë përmirësuar me rreth 50% të metabolitëve të varfër CYP2C19 në krahasim me metabolitët e përsheptuara (shih seksionin 5.2). Inter reaksioni me inhibitor e fortë të CYP2C19, p.sh. omeprazol, lansoprazol, pantoprazol, rabeprazole, fluoxetine, fluvoksamin nuk mund të përjashtohet.

4.6 Aplikimi në periudhën e shtatzënisë dhe laktacionit

Shtatzënia

Nuk janë publikuar studime të kontrolluara mirë me gratë shtatzënë. Megjithatë, sasia e konsiderueshme e të dhënave nuk ka zbuluar dëshmi për indukcionin e malformacioneve kongjenitale me sertralin. Studimet në kafshët kanë treguar se ekzistojnë dëshmi për efektet në reproduktion për shkak të toksitetit tek nënat të shkaktuara me efektin farmakodinamik të këtij medikamenti dhe/ose efektin direkt farmakodinamik në fetus (shih seksionin 5.3).

1.3.1	Sertraline
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

Është vënë re se përdorimi i sertralinës gjatë shtatzënisë ka shkaktuar simptoma të cilat iu janë përgjigjur simptomave të ndalimit të disa të posalindur. Ky fenomen është vënë re edhe me antidepressivë të tjerë SSRI. Aplikimi i sertralinës nuk rekomandohet gjatë shtatzënisë, përveç në rastet kur dobia e prituri nga shërimi tejkalon rrezikun potencial.

Foshnjat e posalindura duhet monitoruar nëse nëna ka vazhduar ta përdorë sertralinën gjatë stadiumit të vonshëm të shtatzënisë, posaçërisht në tremujorin e tretë të shtatzënisë. Tek të posalindurit mund të lajmërohen këto simptoma si pasojë e aplikimit të sertralinës tek nëna në stadiumet e vonshme të shtatzënisë: distresi respirator, cianoza, apneja, konvulsionet, jostabiliteti i temperaturës, të ushqyerit e vështirësuar, të vjella, hipoglikemia, hipertonia, hipotonia, hiperrefleksioni, tremori, dridhjet, iritimi, letargjia, të qajturit pa ndërprerë, pagjumësia dhe problemet me gjumë. Këto simptoma mund të shkaktohen ose me veprim serotoninergjik ose apstinencial. Në shumicën e rasteve, komplikimet fillojnë menjëherë ose direkt, (<24 orë), pas lindjes.

Të dhënat epidemiologjike sugjerojnë përdorimin e barnave të grupit SSRI në shtatzëni, posaçërisht në gjysmën e dytë të shtatzënisë, rritet rreziku nga hipertenzioni persistent i mushkërive tek të posalindurit (PPHN). Rreziku i vërejtur ka qenë rreth 5 raste në 1000 shtatzëni. Në popullatën e përgjithshme ndodhin 1 deri 2 raste PPHN në 1000 shtatzëni.

Laktacioni

Të dhënat e publikuara lidhur me përqëndrimin e sertralinës në qumshin e nënës tregojnë se sasi të vogla të sertralinës dhe metabolitit të saj, N-desmetilsertralinë, ekskretohen në qumësht. Më së shpeshti janë përqëndrime të cilat janë gjetur në serum dhe në foshnjë dhe kanë qenë të papërfillshme ose nuk kanë mund të zbulohen, përveç një përjashtimi ku përqëndrimi në plazmë ka qenë 50% nga përqëndrimi tek nëna (por nuk janë vërejtur efekte të dukshme në shëndetin e foshnjës). Deri tani nuk janë shënuar efekte të padëshirueshme në shëndetin e foshnjave të posalindura nënat e të cilave përdorin sertralinën, por rreziku nuk mund të përjashtohet. Nuk preferohet aplikimi tek nënat në gjë përveç nëse, sipas vlerësimit të mjekut, dobia e tejkalon rrezikun.

Fertiliteti

Të dhënat e fituara nga kafshët nuk kanë treguar efektin e sertralinës në parametrat e fertilitetit (shih seksionin 5.3). Raportet për rastet njerëzore me disa SSRI kanë treguar se ndikimi në kualitetin e spermës është reverzibil. Ndikimi në fertilitet tek njerëzit deri më tani nuk është vërejtur.

4.7 Ndikimi në aftësitë psikofizike gjatë drejtimit të automjetit motorik dhe përdorimi i makinave

Hulumtimet klinike farmakologjike kanë treguar që sertralina nuk ndikon në rezultatin psikomotorik. Megjithatë, psikotropikët mund të zvogëlojnë aftësitë mentale ose fizike të cilat janë të domosdoshme për kryerjen e detyrave potencialisht të rrezikshme për jetën, siç janë drejtimi i automjetit motorik ose përdorimi i makinave dhe pacientët duhet të paralajmërohen, në përputhje me këtë.

4.8 Efektet e padëshiruara

